



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:159182

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521361

PPP.nr.23/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG, Departamenti i Pergjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KESco) me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, numër 5, ndaj debitorit B.B, nga fshati T., Komuna I., nga baza juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.194/2023 i datës 10.07.2023, jashtë seancës gjyqësore, me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit B.B, nga fshati T., Komuna I., i parashtruar kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.194/2023 i datës 10.07.2023.

II.SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbartuesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.194/2023 i datës 10.07.2023.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(Kesco) me seli në Prishtinë, me datë 10.07.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 23.12.2015 deri me datën 10.06.2023, baza juridike borxh në vlerë prej 502.70 €.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrit P.nr.194/2023 të datës 10.07.2023, ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datë 17.07.2023 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhëri përmbartimor, duke u thirr në parashkrimin e borxhit,.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka propozuar që urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi, duke shtuar se pretendimi i debitorit se borxhi është parashkruar, nuk qëndron pasi që kreditori ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej datës 23.12.2015 deri me datën 10.06.2023 në shumën prej 502.70 euro. Më tej ka shtuar se tek transaksionet e debitorit shihen pagesa të kryera me çrast me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit ex lege, ky fakt shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe atë konform nenit 368 të LMD-së.

Gjykata në procedurën përmbartimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e pales debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është në tërësi i bazuar.

Në propozimin për përmbartim të datës 10.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri me Urdhrin P.nr.194/2023, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 23.12.2015 deri me datën 10.06.2023.

Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit gjen se prapësimi i debitorit është i bazuar, duke u bazuar në nenin 360 të LMD, paragrafët 1, nën paragrafi 1.1., 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë; 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.* Gjykata gjen se, në bazë të ekstraktit nga librat afarist, debitori nga data 23.12.2015 e deri më datën 07.01.2016 ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 9.88 €, kurse nuk ka bërë pagesë e që borxhi i mbetur për vitin 2015 është në vlerë prej 9.88. Në vitin 2016 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 341.53 €, kurse ka bërë pagesë të energjisë elektrike, prej 200 € e që borxhi i mbetur për vitin 2016 është 141.53 €. Në vitin 2017 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 165.27 €, dhe nuk ka bërë pagesë e që borxhi i mbetur për vitin 2017 është 165.27 €. Në vitin 2018 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 € dhe nuk ka bërë pagesë, e që borxhi i mbetur për vitin 2018 është në vlerë prej 22.56 €. Në vitin 2019 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 € dhe nuk ka bërë fare pagesë të energjisë elektrike, e që borxhi i mbetur për vitin 2019 është në vlerë prej 22.56 €. Në vitin 2020 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 € dhe nuk ka bërë fare pagesë të energjisë elektrike, e që borxhi i mbetur për vitin 2020 është në vlerë prej 22.56 €. Në vitin 2021 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 €

dhe nuk ka bërë pagesë, e që borxhi i mbetur për vitin 2021 është në vlerë prej 22.56 €, Në vitin 2022 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 € dhe nuk ka bërë pagesë, e që borxhi i mbetur për vitin 2022 është në vlerë prej 22.56 €, ndërsa për vitin 20023, debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 12.12. € dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 50 €, e që si rezultat nuk ka fare borxh për këtë periudhë.

Sipas vlerësimit të gjykatës borxhi i vitit 2015, vitit 2016, vitit 2017, vitit 2018, vitit 2019, vitit 2020 dhe vitit 2021 në vlerë të përgjithshme prej 496.92 € është i parashkruar, pasi që afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Së këndejmi, borxhi i vitit 2015 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2015, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2016, borxhi i vitit 2016 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2016, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2017, borxhi i vitit 2017 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2017, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2018, borxhi i vitit 2018 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2018, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2019, borxhi i vitit 2019 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2019, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2020, borxhi i vitit 2020 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2020, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2021, borxhi i vitit 2021 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2021, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2022 kurse përmbartimi është lejuar me datën 10.07.2023. Rrjedhimisht , gjykata duke u bazuar në këto gjetje, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Më tej, debitori gjatë vitit 2022, në bazë të ekstraktit nga librat afarist, ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 22.56 €, dhe nuk ka bërë pagesë, kurse në vitin 2023 deri më datë 30.06.2023, debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 12.12 €, dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 50 €. Duke qenë se shumica e pagesës prej 50 € tejkalon shumën e shpenzimit të energjisë elektrike për vitin 2022 deri me datën 30.06.2023, gjykata vlerësoi se debitori nuk ka fare borxh ndaj kreditorit, për çka edhe e aprovoi në tërësi prapësimin.

Lidhur me pretendimin e kreditorit se pagesat e bëra nga debitori kanë ndërprerë parashkrimin, konform nenit 368 të LMD në paragrafët 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit*, gjykata i vlerësoi si të pabazuara, sepse sipas vlerësimit të gjykatës parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë dhe se pagesat e bëra nga debitori nuk e ndërprejnë parashkrimin, pasi që nuk kemi të bëjmë me pagesë të këstit, ngase pagesa e këstit mund të bëhet vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara,

ndërsa pagesat e rregullta bëhen nga ana e debitorit varësisht nga shërbimet e marra nga kreditori. Së këndejmi, këto pagesa nuk nënkuptojnë se debitori ka vullnet për pranimin e borxhit në tërësi. Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera nga palët por ishin pa ndikim në marrjen e këtij vendimi, andaj nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.23/2023, me datë 28.03.2024

G j y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.